



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

FINANCUAR NGA:



AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION

INFORMATË PËR MEDIA

Lansimi i Publikimit: Buxhetimi për bujqësi dhe zhvillim rural më të mirë

*10 Tetor, 2017, 10:45 – 12:00
Salla e Konferencave Orion, Prishtinë*

Në gusht të vitit 2016, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) u zotua të zbatojë Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinator, në pajtueshmëri me obligimet ligjore të caktuara në Ligjin për Barazi Gjimore dhe kërkesat e bëra nga Ministria e Financave në qarkoret e fundit buxhetore.

Që atëherë, zyrtarët e MBPZhR-së kanë marrë përkrahje nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) për kryerjen e analizës gjimore të programeve dhe shpenzimeve të mëparshme dhe të tashme. Kryerja e kësaj analize gjimore është esenciale për tu siguruar që janë dhënë të dhëna të mjaftueshme në planifikimin buxhetor për vitin 2018 dhe më tej.

RrGK ka kënaqësinë të ju ftojë në publikimin e rezultateve të përpjekjeve të përbashkëta, që kanë rezultuar në publikimin e një raporti të ri, me titull ***Buxhetimi për bujqësi dhe zhvillim rural më të mirë***. Gjatë këtij lansimi, RrGK do të prezantojë të gjeturat kyçe dhe rekomandime të arritura nga analiza, si dhe mirëpret diskutim sa i përket të gjeturave.

Kjo iniciativë u bë e mundur falë mbështetjes së Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Mediat janë të mirëseardhura për të marrë pjesë.

Për më shumë informata na kontaktoni përmes adresës tonë elektronike info@womensnetwork.org ose përmes telefonit në numrin +381 (0) 38 245 850.